


# BËHU AKTIV EDHE TI



# AKTIVIZOHEMI PËR ZHILLIMIN E DEMOKRACISË


LEONARD (12), VALON (11), ARIAN (13), ALKETA (12), ANDUENA (12), RINESA (12)



**Zhvillimi i mëtutjeshëm i demokracisë është synimi ynë. Por, si mund të ndikojmë ne në këtë zhvillim? Këtë përgjigje do ta mësoni në këtë artikull, të shkruar me shumë dashuri për ty**

Fillet e para të demokracisë nuk ishin edhe aq të lehta. Kalimi nga një formë e qeverisjes jo demokratike në demokraci, kishte përfshirë një lloj tranzicioni të madh. Ky ndryshim që është shënuar nga viti 507 p.e.s. në kryeqytetin e Greqisë, Athinën, mbeti në histori dhe shënoi progres të vazhdueshëm në jetën e

het me rolin aktiv që duhet ta kenë qytetarët. Nëse themi se demokracia ka shënuar zhvillim që nga koha e Athinës, këtë zhvillim ua adresojmë qytetarëve aktiv me iniciativat pozitive që kanë marrë. Kjo nënkupton se aktivizimi i qytetarëve në zbatimin e përpiktë të elementeve demokratike, ka ndikuar në zhvillimin e demokracisë. Duke kuptuar rolin e qytetarëve aktiv, edhe ne si nxënës jemi duke propozuar ide të ndryshme se si mund të kontribuojmë në rritjen e vlerave të demokracisë. Po ashtu, ne bëjmë gjithmonë zbatimin e elementeve të saj, si brenda ashtu dhe jashtë ambientit të shkollës. Këtë e bëjmë duke zgjedhur me vota kryetarin e klasës, duke treguar respekt për mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës, duke iu ndihmuar qytetarëve të cilët kanë nevojë, duke u treguar tolerant dhe të sjellshëm më të tjerët, etj. Prandaj, ne kërkojmë mbështetjen tuaj. Pa ju dhe pa ne, shteti nuk mund të ngritet. Ne kemi vlerë, sepse jetojmë në demokraci. Prandaj, jeni mirënjohës ndaj saj.



qytetarëve. Falë daljes në pah të sistemit demokratik, jeta e qytetarëve mori kahje shumë pozitive. Kjo ka ndodhur sepse në demokraci përfshihen elemente shumë të mira. Me respektimin e tyre, ne rregullojmë jetën tonë dhe të gjithë qytetarëve. Elementet për të cilat po flasim janë: liria, respekti, paqja, të drejtat e barabarta, toleranca, solidariteti, etj. Përmendja e këtyre elementeve dhe zbatimi i tyre, automatikisht lid-



**Ne e duam dhe e mbrojmë demokracinë**



Jemi shumë të lumtur që jetojmë në një vend demokratik. Edhe më të lumtur na bëri fakti që sot ishim gazetarë demokratikë




Ta mbajmë ambientin e pastër dhe të jemi sa më aktiv. Vetëm kështu mund të ndikojmë që shteti ynë të jetë shembull për të tjerët



Vota e secilit ka peshë të madhe në demokraci, sepse me anë të votës zgjedhim përfaqësuesit, të cilët pastaj marrin vendime që do të ndikojnë drejtpërdrejt në jetën tonë



Ne sot punuam në grupe, mirëpo secili e ka pasur rolin e caktuar. Ndarja e roleve është bërë në mënyrë demokratike dhe secili kishte të drejtë të shpreh mendimin e vet



Të jetosh në një vend demokratik do të thotë të kesh liri, respekt, tolerancë, solidaritet, diversitet, të drejta, barazi dhe drejtësi. Pasi që ne qytetarët jemi ata të cilët marrim vendime dhe secili prej nesh luan rol shumë të rëndësishëm në vendin ku jetojmë, duhet të jemi sa më bashkëpunues me njëri-tjetrin në mënyrë që vendi ynë të përparojë dhe të ketë një të ardhme të ndritur

## ZBATIMI I LIGJEVE

ERION (12), FATLIND (12), MUHAMET (12), AGNESA (12), DRILON (12), ERJONA (12)



Lirinë dhe të drejtat e barabarta i kemi të garantuara me ligj dhe vendimet për këto ligje merren në institucionin më demokratik, i cili është Kuvendi

**Ne jemi disa nga nxënësit e shkollës „Dëshmorët e Qyqavicës“ nga Skenderaji. Sot kemi pasur rastin të vijmë në projektin „Demos-ti“. Në grupin tonë kemi diskutuar rreth demokracisë dhe Kuvendit. Nëse dëshironi ta dini rëndësinë e këtij institucioni dhe pse njihet si vendi i ligjeve, ju ftojmë ta lexoni artikullin**

Demokracia do të thotë udhëheqje e popullit. Liria si një nga elementet kryesore të demokracisë nënkupton shprehjen e lirë të mendimit dhe të mos nënshtrimit nga askush.

Këtë liri e kemi të garantuar me ligj. Ligjet janë rregulla që ne si qytetarë duhet t'i respektojmë. Ligjet miratohen në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, një nga funksionet e këtij institucioni është funksioni legjislativ. Kuvendin e Kosovës e përbëjnë 120 deputetë, prej të cilëve 100 janë të kombit shqiptar dhe 20 vende janë të garantuara për komunitetet jo shumicë. Duke pasur parasysh që në demokraci ka barazi, atëherë edhe komunitetet e tjera të cilat jetojnë në Kosovë kanë përfaqësuesit e tyre në Kuvend.

Në seancën plenare, përveç deputetëve marrin pjesë edhe ministrat dhe Kryeministri, të cilët mbajnë përgjegjësi për punën e tyre. Andaj, edhe një funksion tjetër i Kuvendit është funksioni kontrollues, sepse me

anë të pyetjeve të cilat iu parashtrihen ministrave, deputetët kontrollojnë Qeverinë.


Deputetët, pra, janë përfaqësuesit e popullit. Pse quhen kështu? Sepse qytetarët e atij shteti i zgjedhin deputetët me votat e tyre. Pastaj, ata i përfaqësojnë qytetarët në Kuvend. Në këtë mënyrë, deputetët flasin dhe marrin vendime në emrin e të gjithë neve, qytetarëve demokratikë. Lexues të dashur, ne fëmijët jemi e ardhmja e këtij vendi. Prandaj, do të mundohemi të mësojmë sa më shumë dhe të punojmë së bashku, duke pasur mirëkuptim dhe tolerancë ndaj njëri-tjetrit. Kështu arrihet paqja dhe kështu të gjithë mund të jetojmë të lumtur në një vend demokratik.



„Deputetët e ardhshëm“

## ZGJEDHJA ËSHTË E JONA

ARDIT H. (12), AGNESA (13), MERITA (13), ARDIT XH. (12), EDUARD (12)



### U kënaqëm dhe mësuam shumë në Punëtorinë „Demos-ti“. Mësojeni edhe ju cila ishte tema e grupit tonë

Sot, ne klasa VII-2, ishim të parët nga shkolla jonë që morëm pjesë në „Demos-ti“. Me shumë kureshtje hymë brenda në hapësirën e kësaj Punëtorie. Momentin që hymë brenda u ndjemë si në shtëpi. Më pas



bëmë aktivitete, u shpallëm gazetarë dhe u ndamë në grupe. Grupi ynë temë diskutimi kishte „Zgjedhjet“. Trajnerja jonë Blerina, na pyeti nëse ne kemi zgjedhur ndonjëherë më parë. Ne u përgjigjëm që nuk kemi zgjedhur ndonjëherë. Pas kësaj, ajo mori dy ngjyra të drurit dhe iu drejtua shoqes sonë Agnesës. Blerina i tha Agnesës të merrte njërin nga ngjyrat. Kur Agnesa e bëri zgjedhjen e saj, Blerina na pyeti çfarë bëri Agnesa tani. Ne të gjithë thamë se Agnesa sapo zgjodhi. Më pas e kuptuam se ne zgjedhim gjatë tërë kohës. Zgje-

dhim lëndën e preferuar, ekipin e zemrës në futboll, si ta kalojmë kohën e lirë, etj. Ne gjithmonë e kemi ditur se për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Megjithatë, nuk e kemi ditur pse është caktuar pikërisht kjo moshë. Gjatë diskutimit në grup kuptuam se procesi zgjedhor është përcaktues i së ardhmes. Kjo për shkak se personat që ne i zgjedhim gjatë këtij procesi do të udhëheqin me vendin tonë. E kjo pa dyshim që ndikon në jetërat e gjithë neve. Prandaj, duhet të jemi të vendosur dhe të pjekur kur duam t'ia besojmë votën tonë dikujt. Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Në zgjedhjet lokale ne zgjedhim kryetarët e komunave përkatëse dhe asamblistët. Kurse në zgjedhjet parlamentare, ne zgjedhim deputetët. Ju mos harroni se vota jonë është vendimtare. Andaj, të votojmë dhe të marrim vendime për veten tonë. Këtë na e mundëson demokracia, forma më e mirë e udhëheqjes.



Gazetarët punëtorë e demokratë



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Dëshmorët e Qyqavicës“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VII-2  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Çirez, Skenderaj